

Prot. 2211/220 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: Partia Lëvizja e Re
Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin LRE, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet një numër prej 7 zyrash zgjedhore të padeklaruara;*
- *3 kandidatë kanë deklaruar pranimin e dhurimeve në vlerë më të madhe së 50.000 lekë, jo nëpërmjet llogarisë bankare;*
- *financieri i partisë ka qenë njëkohësisht edhe kandidat i këtij subjekti;*
- *3 kandidatë kanë kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk e kanë deklaruar këtë shpenzim në raportin e vetëdeklarimit;*
- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezultojnë 7 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezulton 1 zyrë zgjedhore e hapur nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe fotot përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
40.806736, 19.911913	Kuçovë	LRE - Partia Lëvizja e Re		https://drive.google.com/file/d/1Jp8FNSaY1hgBOc8maleYPKcaozCvVJfG/view?usp=share_link
41.3236765, 19.4533163	Durrës	LRE - Partia Lëvizja e Re		https://drive.google.com/file/d/1zxyz-d3c24-dalHv_QrUwu63q0h19i4x/view?usp=share_link

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
41.491837, 20.21888	Bulqizë	LRE - Partia Lëvizja e Re		https://drive.google.com/file/d/1LXuviwltHGIZqO5dlrPs7bVPsxQJ9nFC/view?usp=share_link
40.7263661, 19.5541192	Fier	LRE - Partia Lëvizja e Re	Elvira Elezi	https://drive.google.com/file/d/1GfplSGzNgrGSrKXsbuRhtYReU2TYzrq/view?usp=share_link
41.318274, 19.4520801	Durrës	LRE - Partia Lëvizja e Re		https://drive.google.com/file/d/1xJF0D2L9VnKmmtaGiOnih4L4hO-WyBo1/view?usp=share_link
41.50526, 20.086882	Klos	LRE - Partia Lëvizja e Re		https://drive.google.com/file/d/1YJvpVtYv8Yeii-VVrW3lR7x0swSt65q/view?usp=share_link
40.6766191, 19.4899325	Fier	LRE - Partia Lëvizja e Re	Elvira Elezi	https://drive.google.com/file/d/1Jx8w_1Fp6i5VRHq6gz7HqIN6mlwMM1Jb/view?usp=share_link

Lidhur me pranime të dhurimeve mbi 50.000 lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare

Në raportin e vetëdeklarimit rezulton se kandidatët e mëposhtëm kanë marrë cash shumat e shënuara:

1. Z. Asllan Hoxha 74.200 lekë (e ndarë kjo shumë në dy këste).
2. Z. Fitimtar Lala 236.000 lekë (e ndarë kjo shumë në disa këste).
3. Z. Bledar Lleshi 74.100 lekë (e ndarë kjo shumë në disa këste).

Lidhur me financierin njëkohësisht edhe kandidat

Referuar raportit të vetëdeklarimit dhe listës shumëemërore të kandidatëve të Partisë Lëvizja e Re, rezulton se financieri z. Arsen Lazri është edhe kandidat me numër rendor 5 në Qarkun Durrës.

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të LRE për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Tre kandidatë të LRE, znj. Argita Llani, z. Arian Galdini dhe z. Gent Sinani për faqen në Facebook të cilëve janë paguar shuma të cilat janë të pamundura për t'u indentifikuar saktësisht për shkak se në secilin nga rastet janë më të vogla se 100\$, në raportin e vetëdeklarimit nuk kanë përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se LRE nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania